



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr. Prot.

Data: 20.02.2025

Nr: 122

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN ME  
NR. 11 ID, DATË 11.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË  
KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË  
KONSOLIDUARA/KRIIK**

Sot më datë 20.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/  
KRIIK

**SUBJEKT:** **Zj. Ogerta Manastirliu**  
Ministër i Arsimit dhe Sportit

**Z. Petrit Malaj**  
Ministër i Financave

**Z. Blendi Gonxhe**  
Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

**Zj. Belinda Balluku**  
Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

**Z. Ervin Hoxha**  
Ministër i Brendshëm

Nr: 122

Data: 20.02.2025

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 11 ID, datë 011.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK”

**OBJEKT:** Përdorimi i sloganeve dhe hashtag-eve në postimet e aktiviteteve institucionale të ministrive

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n” dhe pika 2, neni 91, pika 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

### **K O N S T A T O J :**

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 11.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet protokollit, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 11 ID.

Në këtë denoncim KRIIK parashtrohet sa vijon:

*“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në Faqet Zyrtare në Facebook të Ministrive në vend janë duke u përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve.*

*Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare në facebook e Ministrive të mëposhtme:*

- Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Financave;
- Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Brendshme.”

Me vendimin nr. 85, datë 12.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi. Bazuar në këtë vendim, i'u kërkua personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, të Institucioneve subjekt i këtij denoncimi që të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

KQZ administroi pretendimet e përfaqësuesit të:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si më poshtë vijon:

*“Në kushtet kur nuk ka ende të regjistruar kandidatë të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje, konsiderojmë se pretendimi i publikimit /hashtag-eve partiakë/elektorale nuk qëndron ligjërisht dhe denoncimi nuk mund të konsiderohet.*

2. Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacioni, si më poshtë vijon:

*“Gjatë zhvillimit të veprimtarive publike, ashtu sikurse është përcjellë edhe në transmetim në rrjetet sociale, nuk janë përdorur: shenja, logo, slogane, pankarta, materiale propagandistike që identifikojnë subjekt zgjedhor apo kandidat në zgjedhje”.*

3. Ministrisë së Brendshme si më poshtë vijon:

*“Ministria e Brendshme nuk ka publikime me hashtagët e konsideruar me përmbajtje politike, pasi publikimet janë postime në faqet e zyrtarëve drejtues politikë, të cilat vetëm janë shpërndarë në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme”.*

4. Ministrisë së Financave, si mëposhtë vijon:

*“Gjatë publikimeve të saj, në asnjë rast kjo Ministri nuk ka publikuar përmbajtje/postime që të kenë të reflektuara slogane apo # (hashtags) me përmbajtje politike”.*

5. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si më poshtë vijon:

*“Postimet e denoncuara janë transmetime LIVE të aktiviteteve të MIE, të realizuara përmes një regjije televizive, e cila ka akses në faqen e MIE. Gjatë transmetimit ka pasur një gabim teknik dhe regjia ka përdorur në mënyrë të gabuar hashtag-ë të vjetër. Lidhur me këtë gabim, është bërë fshirja e hashtagëve të gabuar nga postimet e denoncuara”.*

Më datë 12.02.2025, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore, ku u ftuan të gjitha palët në proces për t’u shprehur në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në tërësi palët ju qëndruan pretendimeve të paraqitura elektronikisht.

Në vlerësim të pretendimeve të palëve, fakteve dhe provave të administruara në këtë shqyrtim administrativ çmoj se kërkimi sipas objektit i KRIIK, është i mbështetur në ligj, përkatësisht në nenin 91, pika, 1 të Kodit Zgjedhor, *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”.* Po ky nen parashikon se **“burime”** quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit”.

Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në “facebook” apo çdo mjeti tjetër elektronik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin e postimeve apo të ripostimeve të cilat përmbajnë hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike.

Nga hetimi administrativ u provua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet janë bërë në faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook” të institucioneve subjekt i këtij denoncimi.

Pas verifikimeve të kryera nga ana jonë, u konstatua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet, me karakter politik janë fshirë nga rrjetet sociale të institucioneve.

Sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi, duke i’u tërhequr vëmendje Drejtuesve të Institucioneve Publike që të tregojnë kujdes të shtuar në publikimin e postimeve apo ripostimeve të ndryshme me përmbajtje politike apo elektorale, duke mos lejuar shpërndarjen dhe ripostimin e veprimtarive politike apo elektorale të Institucioneve të tyre eprorë, pasi përbën shkelje të dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimin nr. 9, datë 9.3.2021, dhe Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

## **V E N D O S:**

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 11 ID, datë 11.02.2025 të Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara.
2. Rezultatet e këtij Vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Nr: 122

Data: 20.02.2025

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 11 ID, datë 011.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK”